



REPUBLIKA E KOSOVËS
VUSHTRRI



KOMUNA

Drejtoria për Shërbime Publike

Datë 01.05.2019

Informata të përgjithshme në lidhje me politikat e Komunës së Vushtrrisë për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Pra ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Pra në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Komuna e Vushtrrisë, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, ka hartuar dhe miratuar në kuvend Planin për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2016-2020. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin mbi mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Plani përveç synimit dhe objektivave, përmban një studim përmbajtësor të gjendjes ekzistuese dhe mundësive apo alternativave të reja në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e Unitetit janë të definuara sasisë e gjeneruara të mbetjeve në tërë territorin e komunës, e që është 54.6 t/ditë, sasinë që aktualisht deponohet në deponinë regjionale në Gërmovë e që është 36t/ditë, pastaj sasinë dhe përqindjen e mbetjeve nga amvisëria dhe mbetjeve tjera qoftë ato të riciklueshme, qoftë mbetjet tjera në raport me totalin e sasisë së gjeneruar.

Përveç kësaj ky plan në përmbajtjen e saj përmban edhe shkallën e rritjes së sasisë së gjenerimit të mbetjeve e bazuar ekskluzivisht në shkallën e rritjes ekonomike përmes BPV dhe shkallën e rritjes së popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011.

Plani i menaxhimit të mbeturinave synon:

- shtrirjen e ofrimit të shërbimit për menaxhimin e gati të gjitha mbeturinave komunale në tërë

territorin e Komunës së Vushtrrisë me përjashtim të mbeturinave industriale, mbeturinave të rrezikshme dhe mbetjet mjekësore (mbetjet infektive) të cilat do të trajtohen nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës.

- zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, pastaj kompostimit të mbetjeve organike dhe riciklimit të mbetjeve të riciklueshme.

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave përveç krijimit të mekanizmit institucional (emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve) dhe mekanizmit financiar (planifikimin e taksës për mbeturina si e hyrë komunale), ka nënshkruar edhe marrëveshjen e mirëkuptimit me GIZ. Ky partneritet i ndërtuar me GIZ, ka ndikuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të grupit punues, për formësimin e idesë dhe konceptit për menaxhimin e mbetjeve si shërbim prioritar për qytetarët. Në këtë marrëveshje janë të përfshira një varg pilot projektesh si:

- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim për zonën e qytetit, i cili ka filluar së zbatuari nga data 17.04.2018 në PGM-të e ndërtuara,

- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë,

- plani operativ i ndërmarrjes, që parasheh ofrimin e shërbimit në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë, i cili është hartuar dhe ka filluar se zbatuari nga data 23.04.2018.

- kompostimi për zonën e përzgjedhur në fshatin Bukosh me rreth 150 ekonomi familjare që përfshinë furnizimin me 150 komposter 300 [l],

- projekti për ndarjen e mbetjeve në zonën e përzgjedhur dhe shpërndarja e 500 kontejnerëve për ndarje në këtë zonë,

- rishikimi i modelit të operimit që parasheh; kontraktimin e shërbimit me Ndërmarrjen Uniteti për tërë territorin e komunës, mbledhjen e taksës për mbeturina si e hyrë komunale nga data 1 korrik 2018, krijimi dhe zhvillimi i një softwari pra sistemi i menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së koston dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, formimin e një komisioni këshillues, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit.

Prej nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të GAC-it, CE&AE-së dhe OJQ-së JESHIL, për hartimin e planeve si (planit operativ të ndërmarrjes, planit të zgjerimit të shërbimit, planit të riorganizimit të qendrës së qytetit), komuna dhe ndërmarrja janë furnizuar me 262 kontejnerë 1.1 [m³] në vlerën rreth 90 000 €, furnizimin me 100 kontejner 240

[l] për ndarje të mbeturinave në institucione, si dhe furnizimin me 700 kontejner familjar 120 [l] për mbledhje të mbetjeve derë më derë.

Kur jemi te projekti i grumbullimit të mbetjeve të diferencuara, GIZ ka financuar rregullimin e katër platove me rrethojë dhe mbulesë metalike për vendosjen e kontejnerëve të veçantë për hedhje të mbeturinave të ndara. Kontejnerët që janë vendosur dallohen përmes ngjyrës së kapakëve. Kontejnerët e dedikuar për mbetje të ricikluara si letër dhe plastikë, kanë ngjyrë të zezë dhe kapak të verdhë, ndërsa kontejnerët për mbetje organike kanë ngjyrë tërësisht të zezë.

Po ashtu Komuna ka planifikuar 25 000 € dhe ka blerë 1300 kontejnerëve familjar 120 [l] për zgjerim të shërbimit, ndërsa nga fondi për bashkëfinancim janë blerë edhe 2500 kontejner 120 (l).

Numri i përgjithshëm i kontejnerëve të shpërndarë deri më tani është 5800 kontejner 120 l të shpërndarë në 53 fshatra të Komunës së Vushtrrisë.

Me qëllim të nxitjes dhe ndihmesës së komunave në implementimin e Ligjit për Mbeturina, GIZ së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, patën zhvilluar „Garën për Mjedis të Pastër”, në të cilën garë nga skema e granteve Komuna e Vushtrrisë ka përfituar rreth 140 000 € të cilat do të konvertohen në pajisje makinerike për ngritjen e kapaciteteve të Ndërmarrjes UNITETI..

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e deponive ilegale, rritjen e shkallës së inkasimit përmes mekanizmave kushtëzues që parasheh rregullorja për menaxhim të mbetjeve, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim dhe procesit të kompostimit..